
**RAPORT PER AUDITIMIN E FONDEVE TË SHPENZUARA
NGA FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT
PER AKTIVITETET E FINANCUARA NGA
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DHE
MINISTRIA E TURIZMIT KULTURES DHE SPORTIT**

TIRANË, 13.02.2026



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për bordin drejtues të Federates Shqiptare të Notit

Unë, Admir Kajo, Auditues ligjor, me licence profesionale nr. 369 date 15.02.2019 dhe NIPT K71717029E, në bazë të Kontratës së Shërbimit datë 09/02/2026, të lidhur me subjektin Federata Shqiptare e Notit, me qëllim Auditimin e fondeve të shpenzuara në kuadër të granteve të dhena nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit, Kultures dhe Sportit për mbështetje financiare në fushën e sportit të Notit, paraqes raportin e auditimit për dhenien dhe përdorimin e këtyre fondeve.

Opinion

Sipas opinionit tim, duke u bazuar në kërkesat ligjore, gjykoj se Federata Shqiptare e Notit, ka zbatuar drejt kërkesat për përdorimin e fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit në përputhje me buxhetin e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit, Kultures dhe Sportit për mbështetje financiare të granteve në fushën e sportit.

Baza për opinion

Unë si ekspert, jam i pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e këtij projekti në përputhje me Kodin e Etikës për EKR-të, dhe kam përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Unë besoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim.

Kam marrë në shqyrtim të gjitha raportet financiare të përgatitura nga menaxhmenti i federates, grantet e buxhetin e miratuar nga Financuesi dhe dokumentacionin që justifikon këto transaksione dhe shpenzimet.

Kam verifikuar me zgjedhje dokumentacionin që justifikon shpenzimet faktike të raportuara, si faturat, kontratat, mandat pagesat e bankës, pagat, rakordimet me dergjen e thesarit, deklaratimet tatimore, etj.

Unë besoj se evidenca e marrë për auditimin e projektit përmban dokumentacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbështetës për opinionin tim.



Theksimi i çështjes - Baza e kontabilitetit dhe kufizimi në shpërndarje

Pa modifikuar opinionin tim, tërheq vëmendjen për faktin se Federata Shqiptare e Notit është audituar vetëm për shpenzimet e kryera në kuadër të granteve të dhena nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Turizmit Kultures dhe Sportit. Si rezultat, ky raport auditit mund të mos jetë i përshtatshme për qëllime të tjera. Raporti i drejtohet menaxhmentit të Federates Shqiptare të Notit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Turizmit, Kultures dhe Sportit dhe nuk duhet t'i shpërndahet ose përdoret nga palë të treta.

Tirane me 13.02.2026

Adresa:

**Rr. "Hamid Shijaku", Pallati Nr.41/2,
Ap.2, Zyra Nr.1, Tirane
Mob 0692175263
Lic. prof. Nr 369; NIPT K71717029E**

Auditues ligjor
Admir KALO

